



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 10/01/22 Ref.: 29/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, dhe të Vendimit të KShC-së, nr. 3236/21D të datës 21.09.2021; Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 94-të, të mbajtur më 21 dhjetor 2021, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Fakultetit të Studimeve Islame, Nr 3440/21H, datë 22.10.2021 për riakreditim të programit të studimit, si më poshtë:
 - Teologji Islame, MA 60 ECTS, (Ri akreditim)
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Fakulteti i Studimeve Islame ka parashtruar kërkesë (Nr 3440/21H, datë 22.10.2021), në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për akreditim të programit të studimit: Teologji Islame, MA 60 ECTS.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KShC në mbledhjen e mbajtur me 21 dhjetor 2021 ka trajtuar aplikacionin e Fakultetit të Studimeve Islame. Në pikën 1.2 të nenit 10 të UA për Akreditim, thuhet, “Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”.

Këto të dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KSHC-së të mbajtur me 21 dhjetor 2021, dhe pas shqyrtimit të dosjes për secilin staf akademik, KShC mori vendim që të refuzojë pjesërisht aplikacionin e Fakultetit të Studimeve Islame. Bazuar në nenin e referuar më sipër KShC ka verifikuar të gjithë dokumentacionin relevant të kualifikimit të stafit akademik për programet e studimit.

- **Për programin e studimit:** Teologji Islame, MA 60 ECTS, si bartës të këtij programi, ka paraparë këta persona: Xhabir Hamiti (Tefsir).

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Ky program ka 60 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Fakulteti i Studimeve Islame, duhet të ketë të paktën një staf akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.


Pas shqyrtimit të këtij programi të studimit dhe pranimit të informacionit për caktimin e bartësit të programit si ambasador në një shtet tjetër, KShC ka konstatuar se Xhabir Hamiti nuk mund të angazhohet si bartës në këtë program studimi.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër, KShC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit Teologji Islame, MA, 60 ECTS.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Pastaj, ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Studimeve Islame;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hashija Nazi
Kryetare i Këshillit Shkollësor të Cilësive

